

SHTOJCË

Programet e përgjithshme të lëndëve profesionale për të cilat do të hartohen materialet mësimore:

1. Programi i Lëndës

“Riprodhimi i kafshëve”

(L-19-085-16)

Kl. 12 - 72 orë

- **Synimet e lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Riprodhimi i kafshëve” klasa 12, nxënësit duhet:

- Të rendisin shkaqet e dhembjeve të parakoshme dhe të dështimeve në kafshë.
- Të përcaktojnë llojet e dështimeve në kafshët femra.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në pjelljet e vështira në kafshë.
- Të ndërhyjnë në rregullimin e pozicionit të frytit në pjelljet e vështira. –Të përcaktojnë metodat gjatë ndërhyrjeve pa gjak në pjelljet e vështira.
- Të rendisin mjetet dhe instrumentet që përdoren në pjelljet e vështira.
- Të përcaktojnë shkaqet që çojnë në mbetjet e shtratit dhe prolapsin e vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në lopët me mbetje shtratit dhe prolaps të vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme.
- Të përcaktojnë mjekimin për kafshët me mbetje shtrati dhe prolaps të vaginës dhe të mitrës.
- Të rendisin shkaqet që çojnë në pezmatimin e organeve gjinore.
- Të përshkruajnë shenjat klinike të lopëve me pezmatime të organeve gjinore, si të mitrës, të ovidukteve dhe të vezoreve.
- Të përcaktojnë masat parandaluese dhe mjekimin në pezmatimet e organeve gjinore si metrite, patologji të vezoreve, etj.
- Të rendisin shkaqet që çojnë kafshët femranë shterpësi të përkohshme dhe të përhershme.
- Të përkufizojnë shfaqjen e mastiteve në kafshë.
- Të rendisin shkaqet që çojnë në shfaqjen e mastiteve në lopë dhe në kafshë të tjera.
- Të klasifikojnë llojet e mastiteve sipas kohëzgjatjes dhe karakterit të pezmatimit.
- Të përshkruajnë shenjat klinike të lopëve me mastite.
- Të dallojnë mastitet klinike nga mastitet subklinike (të fshehta) në lopë.
- Të përcaktojnë masat parandaluese dhe mjekimin në lopët me mastite.
- Të përcaktojnë shkaqet që çojnë në shfaqjen e plagëve të gjirit dhe të thithave.
- Të përshkruajnë shenjat klinike në kafshët me plagë të gjirit dhe të thithave.
- Të dallojnë mastitet nga plagët e gjirit dhe të thithave në kafshë.
- Të përcaktojnë shkaqet që çojnë në shfaqjen e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë në kafshët e porsalindura.
- Të përshkruajnë shenjat e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë në kafshët e porsalindura.

- Të përcaktojnë masat për parandalimin e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë në kafshët e porsalindura.
- Të përcaktojnë mjekimin për kafshët e porsalindura me asfiksi, ftohje trupore dhe hipoglicemi.

■ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Riprodhimi i kafshëve”, kl. 12 - 72 orë**

Tema 1	Patologjitë e barrës	8 orë
Tema 2	Patologjitë e kafshës në pjelljet e vështira	10 orë
Tema 3	Patologjitë e kafshës pas pjelljes	9 orë
Tema 4	Sëmundjet e organeve gjinore	8 orë
Tema 5	Patologjitë e vezoreve	10 orë
Tema 6	Sëmundjet e gjendrës së gjiri	10 orë
Tema 7	Patologjitë e lëkurës së gjirit dhe të thithave.	8 orë
Tema 8	Sëmundjet e kafshëve të porsalindura	9 orë

2. Programi i Lëndës

“Fidanishte pyjore”

(L-25-142-09)

Kl. 10 - 72 orë

Synimet e lëndës “Fidanishte pyjore”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Fidanishte pyjore.”, kl 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë riprodhimin e bimëve.
- Të përshkruajnë klimën e vendit tonë.
- Të përshkruajnë zonat bimore të vendit tonë.
- Të përshkruajnë grumbujt farorë.
- Të shpjegojnë fenomenin e periodicitetit.
- Të zgjedhin kohën e përshtatshme për mbledhjen e farërave të pjekura.
- Të rendisin hapat e punët për mbledhjen e farërave.
- Të përcaktojnë treguesit cilësorë të farës.
- Të shpjegojnë vlerën kulturore të farës.
- Të shpjegojnë shpejtimin e mbirjes së farërave.
- Të përcaktojnë kriteret e zgjedhjes së vendit për fidanishte.
- Të zbatojnë mbjelljet e farërave në fidanishte.
- Të llogarisin normën e mbjelljes së farës.
- Të përshkruajnë shërbimet pas mbjelljes së farës.
- Të shpjegojnë shpërnguljen e fidanave.
- Të përshkruajnë prodhimin e fidanave me kalem.
- Të zbatojnë standardet e prodhimit të fidanave.

Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Fidanishtet pyjore”, kl 10 - 72 orë

Tema 1	Pylli si burim i prodhimit të lëndës së drurit	7 orë
Tema 2	Klasifikimi dhe zgjedhja e drurëve	7 orë
Tema 3	Klasifikimi dhe zgjedhja e grumbujve farorë	7 orë
Tema 4	Treguesit cilësorë e sasiorë të farërave	10 orë
Tema 5	Veçoritë e mbjelles së farërave	5 orë
Tema 6	Veçoritë e përgjithshme të fidanishteve pyjore	3 orë
Tema 7	Kriteret dhe procedurat e mbjelljes së farërave në fidanishte.	28 orë
Tema 8	Prodhimi i fidaneve me kalem.	3 orë
Tema 9	Standardet e prodhimit të fidaneve.	2 orë

3. Programi i Lëndës

“Ekonomia e ndërmarrjes”

(L-17-245-11)

Kl. 12 - 72 orë

• Synimet e lëndës “Ekonomia e ndërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ekonomia e ndërmarrjes”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë kuptimin, karakteristikat, veçoritë dhe mënyrën e organizimit të ndërmarrjeve prodhuese dhe t’i krahasojnë ato me ndërmarrje të llojeve të tjera nga pikpamja e objektit të veprimtarisë, organizimit dhe e vendit në ekonomi.
- Të shpjegojnë kuptimin, llojet e procesit prodhues dhe mënyrën e organizimit, duke argumentuar përse lloji i procesit prodhues ndikon në mënyrën e organizimit të tij.
- Të përshkruajnë mënyrën e planifikimit të procesit të prodhimit, në vartësi të llojit të tij.
- Të shpjegojnë karakteristikat, veçoritë dhe tiparet e organizimit të ndërmarrjeve të shërbimeve.
- Të përshkruajnë qëllimet sociale dhe ekonomike të ekonomisë së personelit.
- Të shpjegojnë mënyrën e planifikimit, punësimit dhe dokumentimit të personelit.
- Të shpjegojnë si bëhet ndarja dhe organizimi i vendeve të punës dhe çfarë mbahet parasysh gjatë këtij procesi.
- Të përshkruajnë masat që duhet të merren për shëndetin dhe sigurinë në punë.
- Të përshkruajnë sistemet e shpërblimit që aplikohen në njësi të ndryshme ekonomike duke argumentuar domosdoshmërinë e tyre.
- Të përshkruajnë strukturën e pagave, teknikën e llogaritjes dhe të dokumentimit të tyre.
- Të shpjegojnë mënyrën e funksionimit të formave alternative të pagesave.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekonomia e ndërmarrjes kl. 12 - 72 orë

Tema 1	Ndërmarrjet prodhuese dhe organizimi i tyre	8 orë
Tema 2	Proceset e prodhimit: organizimi	6 orë
Tema 3	Proceset e prodhimit: planifikimi i tyre sipas llojit	8 orë
Tema 4	Ndërmarrjet e shërbimeve	10 orë
Tema 5	Ekonomia e personelit dhe qëllimet e saj sociale dhe ekonomike	8 orë
Tema 6	Planifikimi i personelit, punësimi, drejtimi, organizimi, administrimi	8 orë
Tema 7	Ndarja e punës dhe organizimi i vendeve të punës	6 orë
Tema 8	Shëndeti dhe siguria në punë	4 orë
Tema 9	Shpërblimet e punës: sistemet e shpërblimit	4 orë
Tema 10	Struktura e pagave, dokumentimi	6 orë
Tema 11	Format alternative të pagesave	6 orë